REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	02.07.2025
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkryetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – QERSHOR 2025

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.06.2025-30.06.2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuara dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit qershor 2025-janë pranuar gjithsejtë 56-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë 36 lëndë, që në total rezulton të jenë 92 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 74 kërkesa, 54 të miratuara, 16 të refuzuara dhe 4 të ceduara. Për shqyrtim në muajin vijues barten 18 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuara dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në kuadër të planifikimit hapësinor me datën 03.06.2025 është mbajtur debate public lidhur me përgatitjet për inicimin e procedures për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale 2021-2029.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Gjatë muajit qershor 2025 janë lëshuar 24 konkluzione për kategoritë si në vijim:

1. Konkluzion për taksë për leje ndërtimore – 8;
2. Konkluzion për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore 7;
3. Konkluzion për leje mjedisore komunale – 6;
4. Konkluzion për leje rrënimi – 1.
5. Konkluzion për legalizim -2.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

1. Është punuar me Njësinë e Auditimit të Brendshëm lidhur me auditimin e të hyrave ne DPUMM. Është trajtuar Raporti, përkatësisht aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve të caktuara.
2. Vazhdimi i procesit të identifikimit të ndërtesave me materiale asbesti;
3. Hartimi i disa disa detyra projektuese për hartimin e projekteve zbatuese sipas kërkesave të drejtorateve të tjera, duke përfshirë për tregun ditor dhe sallen e sporteve të shkollës “Ismail Luma”;
4. Puna në raportin e përformancës;
5. Është përgatitur dokumentacioni për pagesen e operatorëve për hartimin e projekteve.
6. Pjesëmarrja në takimin lidhur me zbatimin e Rregullores Nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur.
7. Janë pranuar katër (4) kërkesa (dy prej tyre nga grupe të qytetarëve) për ndryshimin e HZK-së;
8. Është proceduar me kërkesen për bartjen e mjeteve financiare për Drejtoratin e Administratës.
9. Është proceduar me kërkesen për rishpallje të procesit për angazhimin e një konsulenti/e.

Në kuadër të trajtimit të kërkesave, janë shqyrtuar edhe plotësimet e dokumentacionit të cilat i kanë parashtruar palët bazuar në ftesat e dërguara nga DPUMM për shkak se kërkesat ishin të pakompletuara.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:
Në process është vlerësimi i rezultateve në punë për punonjësen Arbnore Bërbatovci.
Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.
Vazhdimi i bashkëpunimit me Drejtoratet relevante në procesin implementues të projekteve komunale.
Çështja e funksionalitetit të Këshillave të banimit.
Vazhdimi i punës në identifikimin e ndërtesave me materiale asbesti.
Përgatitja e Raporti 6 mujor të punës së DPUMM-së.
Përgatitja e Raportit vjetor për monitorimin e zbatimit të HZK-së.
Plotësimi i Planit të veprimit për Raportin e Integritetit dhe Planit të veprimit për Agjenden Evropiane.
Përgatitja e Propozim Vendimit për inicimin e ndryshimit dhe plotësimit të HZK-së.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 1.

Nr.	*Llojet e kërkesave*	*Të pranuara*	*Nga periudha e kaluar*	*Të miratura*	*Të pezullua ra*	*Të refuzua ra*	*Të bartura në sektor të tjerë*	*Në proces (pritje)*
1.	Kushte ndërtimore	8	9	9		2		6
2.	Leje ndërtimi	5	11	6		7[1]		3
3.	Leje rrënimi		1					1
4.	Certifikatë përdorimi		1			1		
5.	Pëlqime parimore për solar	1		1			1	
6.	Akte nga MMPHI me efekte juridike		1	1				
	Akte të kthyera nga MMPHI	2					2	
7.	Informacione urbane	7	1	8				
8.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	4	3	4				2
9.	Legalizimi/ Në listë të pritjes			1				
10.	Bashkim/ndarje e parcelave		2			2		
11.	Ankesa	3				1[2]	1	1
13.	Kërkesë për vazhdimin e kushteve ndërtimore	1	1	2				
14.	Kërkesë për LMK	6	6	5		1		5
15.	Detyra për hartim të projekteve	13		13				
16.	Qasje në dokumente	4		4				
17.	Lejim i punimeve KUR	1				1		
18.	Vendosje reklame	1				1		
	Gjithsejtë:	56	36	54		16	4	18

Në kuadër të kërkesave të shqyrtuara janë trajtuar edhe dy kërkesa shtesë për plotësim dokumentacioni.

[1] Për një kërkesë për Leje ndërtimi është lëshuar "Njoftim" për shkak se nuk kishte kushte për shqyrtimin administrativ të kërkesës.
[2] Për një "Ankesë" është lëshuar "njoftim" për shkak mungesës së kompetencës lëndore për shqyrtim.

DPUMM ka trajtuar edhe 4 kërkesa për qasje ne dokumente. Të gjitha kërkesat janë proceduar me kohë.

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 2.

Nr.	***Kategoria e ndërtimit***	***Sipërf. Tokës – m2***	***Sip.ndëtesës- m2***	***Destinimi***	***Vendi***
1.	II	4821	1706.23	Afarist	Banullë
2.	II	262	194.5	Afarist	Lipjan
3.	II	9433	8791.41	Afarist	Qylagë
	II	1350	1263.58 6668.16	Afarist Banimi	Lipjan
3.	I	1913	513	Afarist	Lipjan
4.	I	1187	304.80	Afarist	Rubovc
4	I	450	218.18	Banim	Lipjan
Gjithsejtë		19416	19355.06		

Tokë e shfrytëzuar për afarizëm = 17616 m2 me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 12468.72 m2.
Tokë e shfrytëzuar për banim = 1800 m2 me gjithsejtë ndërtim për banim prej 6886.34 m2.

DISKUTIME PUBLIKE:
Gjatë muajit qershor 2025 kemi pasur diskutimin publik lidhur me përgatitjen e procesit për plotësimin dhe ndryshimin e HZK-së.

SFIDAT:
- Mungesë e theksuar e stafit në punë për shkak të pushimeve mjekësore;
- Procesi për plotësimin e dy vendeve të lira të punës ende nuk është realizuar.

BUXHETI:

Gjatë muajit raportues kemi vazhduar me realizimin e të hyrave nga trajtimi i kërkesave për leje ndërtimore dhe kategoritë tjera. Gjatë muajit qershor 2025 janë realizuar të hyra si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:……..….34,366.19€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej: ……..……7,645.10€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej……..…..5.659.32€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:…….....…519.27€

Te hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej .....…….....….....338.15€

Shuma totale e të hyrave: ……..…...…...48,189.88€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin qershor 2025 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.